

## SHTOJCA 2 – INSTRUMENT PËR ZHVILLIMIN E PLANEVE KOMUNALE TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT JASHTË SHKOLLE DHE PARANDALIMIN E BRAKTISJES SË SHKOLLËS NË KOSOVË

Ky instrument ka tri seksione:

1	Struktura e planit komunal të veprimit .....	1
2	Dimensionet që duhet marrë parasysh kur planifikohet .....	3
3	Formulari i planit të veprimit.....	18

### 1. STUKTURA E PLANIT TË VEPRIMIT

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në përgjithësi struktura e planeve komunale të veprimit dhe përmbledhja e përmbajtjes së secilit seksion.

Titulli	Përfshin periudhën e mbuluar nga plani
<b>Hyrje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Definon terminologjinë përkatëse si “fëmijët jashtë shkolle”, “braktisja”, “mungesa me arësye dhe pa arësye”, “mos-vijimi i gjatë”</li> <li>Shpjegon qëllimin e planit</li> <li>Kujton Politikat dhe strategjitë kombëtare që i përgjigjen Planit, veçanërisht objektivave kryesore të Planit kombëtar të veprimit për parandalimin e braktisjes 2009-2014, Strategjinë Kombëtare për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas dhe Planin për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.</li> <li>Shpjegon si dhe nga kush është zhvilluar Plani</li> </ul>
<b>Analiza e gjendjes</b>	<p>Bazuar në të dhënat në dispozicion, kjo pjesë paraqet natyrën e problemit të fëmijëve jashtë shkolle, veçanërisht braktisjen në komunën përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Profilin e fëmijëve të cilët kurrë nuk janë regjistruar në shkollë në komunën përkatëse</li> <li>Profilin e fëmijëve të cilët regjistrohen në shkollë me vonesë në komunën përkatëse</li> <li>Profilin e fëmijëve të cilët e braktisin arsimin e obliguar në komunën përkatëse</li> <li>Identifikimi i fshatrave ose shkollave me shkallë të lartë të fëmijëve të mos-regjistruar në shkollë ose braktisje të shkollës</li> <li>Analiza e pengesave për regjistrim, përfundim dhe diplomim dhe arsyeve të braktisjes së shkollës</li> <li>Paraqitja e shërbimeve mbështetëse ekzistuese qeveritare dhe atyre joqeveritare rreth arsimit në përgjithësi, përfshirë mbështetjen për regjistrim, ndërmjetësim me komunitetin, mbështetje në mësimxënie dhe gjuhë dhe rreth shërbimeve sociale (mbulimin e regjistrimit dhe mbështetjen për dokumentacion, përfitime dhe mëditje, shërbime sociale, shërbime shëndetësore dhe shërbime për të rinj)</li> <li>Përparësitë dhe mangësitë e arsimit ekzistues dhe shërbimeve mbështetëse</li> <li>Mësimet e nxjerra nga ndërhyrjet e mëhershme, duke i pasur si cak fëmijët braktisës dhe fëmijët jashtë shkolle</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimet e nxjerra nga aktivitetet e planifikuara të mëparshme, të realizuara nga komuna (p.sh. Planet e veprimit për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas);</li> </ul> <p>Të dhënat për mbështetjen e analizës mund të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Numrin dhe shkallën e fëmijëve që vijnë arsimin në fëmijëri të hershme dhe atë parashkollor (të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe zonës gjeografike, nëse ka në dispozicion)</li> <li>Numrin dhe shkallën e fëmijëve që vijnë arsimin fillor (të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe zonës gjeografike, nëse në dispozicion)</li> <li>Numrin dhe shkallën e fëmijëve që vijnë arsimin e mesëm të ultë (të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe zonës gjeografike, nëse në dispozicion)</li> <li>Numrin dhe shkallën e fëmijëve që vijnë arsimin e mesëm të lartë (të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe zonës gjeografike, nëse në dispozicion)</li> <li>Numrin dhe shkallën e fëmijëve jashtë shkolle (nëse ka në dispozicion)</li> <li>Numrin dhe shkallën e nxënësve braktisës, sipas klasës, gjatë 3 viteve të kaluara</li> <li>Numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës shkollore në komunën përkatëse</li> <li>Shkallën e popullatës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas</li> <li>Numrin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të moshës shkollore</li> </ul>
<b>Prioritete dhe synimet</b>	<p>Bazuar në analizën e gjendjes, identifikoni prioritetet kyçe për periudhën e Planit. Zhvilloni synimet për t'i trajtuar fushat me prioritet. Rekomandohet që të identifikohen jo më shumë se 2-3 synime.</p>
<b>Plani i veprimit</b>	<p>Plani veprimit do të përfshijë për çdo synim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Emrin e synimit</li> <li>Realizimin e aktiviteteve për arritjen e synimit</li> <li>Afatin kohor për realizimin e aktivitetit</li> <li>Zyrtarin përgjegjës ose agjencinë për zbatim</li> <li>Shpenzimet e aktivitetit</li> <li>Burimi financiar për aktivitetin</li> <li>Treguesit e performancës</li> </ul> <p>Shihni pjesën 3 të këtij instrumenti për të parë Shabllonin e Plan Veprimit</p>
<b>Monitorimi dhe vlerësimi (M&amp;V)</b>	<p>Në këtë pjesë jepen informata për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ciklin e rishikimit (rekomandohet të bëhet në baza vjetore)</li> <li>Modalitetet e rishikimit</li> <li>Modalitetet e M&amp;V<sup>1</sup></li> <li>Zyrtarin përgjegjës ose agjencinë për M&amp;V</li> </ul>

<sup>1</sup> Modalitetet e M&V do të ndryshojnë varësisht prej strukturave ekzistuese dhe mekanizmave në secilën komunë. Mbledhjet mujore rekomandohen, që të përcjellin rastet e fëmijëve në mënyrë adekuate.

---

## 2. DIMENSIONET QË DUHET MARRË PARASYSH KUR PLANIFIKOHET

Në këtë pjesë identifikohen dimensionet kyçe për të cilat duhet menduar kur trajtohen çështjet e fëmijëve jashtë shkolle dhe braktisja. Artikulohet rreth disa "moduleve" ose "blloqeve" tematike për lehtësimin e përdorimit. Çdo "modul" ofron informata mbi:

- Çështjet që po përpiqemi t'i trajtojmë
- Qëllimin që duam ta arrijmë
- Aktivitetet e mundshme që mund t'i kontribuojnë arritjes së qëllimit
- Përfshirjen e akterëve
- Çështjet që duhet të merren parasysh.

Këto module janë vetëm indikative. Ato ofrojnë një bazë për diskutim dhe udhëzim, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, për mënyrën se si të adresohen çështjet specifike. Çdo komunë mund të kërkojë, zgjedhë, ndryshojë, bashkojë modulet dhe aktivitetet, që përshtaten më së miri me problemet e tyre të caktuara dhe synimet vetanake. Modulet mbulojnë temat në vijim:

[Moduli 1](#): Identifikimi, monitorimi dhe raportimi i fëmijëve jashtë shkolle ose në rrezik të braktisjes së shkollës

[Moduli 2](#): Regjistrimi i informatave për fëmijët jashtë shkolle dhe nxënësit braktisës

[Moduli 3](#): Përgatitja për regjistrim në klasën I

[Moduli 4](#): Sistemi arsimor për ngritjen e vetëdijësimin të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas

[Moduli 5](#): Dokumentimi dhe regjistrimi

[Moduli 6](#): Fillimi i sigurtë me arsimim në fëmijërinë e hershme

[Moduli 7](#): Mbështetja e plotë për nxënësit në rrezik të braktisjes

[Moduli 8](#): Mbështetja për mësimnxënie për nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës

[Moduli 9](#): Mos-vijimi

[Moduli 10](#): Çështjet financiare, materiale dhe transporti

[Moduli 11](#): Gjithëpërfshirja dhe siguria në komunitet dhe në shkolla

[Moduli 12](#): Shërbimet rinore të komunitetit dhe mbështetja

[Moduli 13](#): Nga arsimi joformal në atë zyrtar

[Moduli 14](#): Mbështetja e shkollave

[Moduli 15](#): Grumbullimi i të dhënave dhe monitorimi

[Moduli 16](#): Shërbimet për fëmijët e riatdhesuar dhe ata të kthyer

<b>Moduli 1: Identifikimi, monitorimi dhe raportimi për fëmijët jashtë shkolle ose në rrezik të braktisjes së shkollës</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e listave të përditësuara për fëmijët e moshës shkollore, të klasës I</li> <li>• Mungesa e sistemit të bashkëpunimit dhe referimit ndërmjet sektorëve</li> <li>• Mungesa e mekanizmave monitorues për rastet e braktisjes</li> <li>• Mungesa e të dhënave të përputhshme për rastet e fëmijëve</li> </ul>
Qëllimi	Të zhvillohet një sistem për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve jashtë shkolle ose në rrezik të braktisjes së shkollës
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi dhe zbatimi i sistemit të identifikimit dhe monitorimit për fëmijët jashtë shkolle dhe nxënësit në rrezik të braktisjes (shih kapitullin 2)</li> <li>• Mbështetja e EPRBM-ve të shkollës në zbatimin e sistemit të menaxhimit të rasteve, në sistemin për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve jashtë shkolle dhe nxënësit në rrezik të braktisjes</li> <li>• Identifikimi i akterëve dhe zyrtarëve përgjegjës për secilën fazë/komponentë të sistemit</li> <li>• Ndarja dhe shpërndarja e sistemit të gjithë akterëve përkatës</li> <li>• Zhvillimi i mekanizmave të referimit në të gjithë sektorët dhe akterët</li> <li>• Sigurimi i rasteve të fëmijëve që të regjistrohen në mënyrë të duhur (shihni Modulin 2)</li> <li>• Zhvillimi i sanksioneve për mos-respektimin e detyrimeve për referim dhe raportim</li> <li>• Zhvillimi i kanaleve të komunikimit të qartë dhe praktikave të ndarjes së informatave me shërbimet shëndetësore dhe sociale për të trajtuar në mënyrë adekuate rastet e fëmijëve në rrezik, fëmijëve viktimë të traumave dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara.</li> </ul>
Akterët	Ekipeve komunale, DKA, shërbimet sociale dhe shëndetësore, përfaqësuesit e policisë, EPRBM shkollore, OJQ-të dhe MASH-T-i
Çështjet që duhet marrë parasysh	<p><u>Elementet që duhet pasur parasysh kur të zhvillohet sistemi:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I njëjti sistem duhet të ndahet me sektorët: arsimit nuk është përgjegjësi i vetëm për identifikimin dhe monitorimin e rasteve të braktisjes</li> <li>• Emërimi i personit më të moshuar për mbikëqyrjen e zbatimit të procesit</li> <li>• Çdo sektor/akter mund t'i mbajë të dhënat e veta, por këto duhet të bashkërendohen në një bazë të vetme të të dhënave në nivel të komunës.</li> <li>• Mbajtja e thjeshtë e sistemit</li> <li>• Të menduarit për mekanizmat e ndarjes së të dhënave ndërmjet arsimit, shëndetësisë, policisë dhe shërbimeve sociale, në mënyrë që në mënyrë adekuate të trajtohen dhe menaxhohen rastet e fëmijëve në kundërshtim me ligjin, fëmijëve në rrezik të abuzimit si viktimë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.</li> </ul>

<b>Moduli 2: Regjistrimi i të dhënave për fëmijët jashtë shkolle dhe nxënësit braktisës të shkollës</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e mos-përputhjes në regjistrimin e rasteve të fëmijëve braktisës ose jashtë shkolle</li> <li>Mungesa e të dhënave të përditësuara për braktisje dhe fëmijët jashtë shkolle</li> <li>Profili jo i saktë i fëmijëve jashtë shkolle</li> </ul>
Qëllimi	Të regjistrohen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme fëmijët braktisës dhe jashtë shkolle
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Emëroni një zyrtar komunal, përgjegjës për të dhënat e fëmijëve që mungojnë në mësim, në komunën përkatëse</li> <li>Publikoni emrin dhe hollësitë kontaktuese të zyrtarit përgjegjës në të gjitha shkollat dhe tek të gjithë akterët institucional dhe jo-qeveritar</li> <li>Paralajmëroni të gjithë akterët institucionalë dhe jo-qeveritar se si t'i referohen fëmijës, i cili nuk ndjek shkollimin ose nuk është i regjistruar në shkollë</li> <li>Përdorni (dhe ndoshta edhe rregulloni), një formularë për të regjistruar rastet e të gjithë fëmijëve jashtë shkolle</li> <li>Siguroni që të dhënat për fëmijët do të mbrohen</li> <li>Analizoni të dhënat vjetore të profilit të fëmijëve jashtë shkolle për të vlerësuar efektivitetin e strategjive për përfshirjen e tyre në shkollë dhe të shërbejnë si informacione për planifikim dhe praktikata e ardhshme</li> </ul>
Akterët	DKA, Ekipet komunale, shërbimet shëndetësore dhe sociale, përfaqësuesit e policisë, EPRBM shkollore, OJQ-të
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p><u>Formulari për regjistrimin e të dhënave:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çdo sektor / akter mund të mbajë të dhënat e veta, por ato duhet të jenë në pajtim me një bazë të vetme të të dhënave në nivel të komunës.</li> <li>Formulari për regjistrim i komunës, që mund t'i përshtatet nevojave të komunës mund të gjendet në Shtojcën 3, instrumenti 6.1. Vendosni pas sa ditëve të mungesës së pa-arsyeshme të një fëmijë se duhet të përfshihet në bazën e të dhënave.</li> </ul>

<b>Moduli 3: Përgatitja për regjistrim në klasën e I-rë</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e listave të përditësuara të klasës I për fëmijët e moshës shkollore</li> <li>Njoftimi i kufizuar i prindërve për procesin e regjistrimit</li> </ul>
Qëllimi	Të sigurohet që të gjithë fëmijët e klasës I, të moshës shkollore të regjistrohen me kohë
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zyra e regjistrimit civil të sigurojë listat e fëmijëve të klasës I, të moshës shkollore bazuar në regjistrat e lindjes</li> <li>Kujdesi në fëmijërinë e hershme dhe qendrat e edukimit të sigurojnë listën e fëmijëve të klasës I, të moshës shkollore bazuar në listat e regjistrimit</li> <li>OJQ-të të sigurojnë listën e tyre për fëmijët e moshës shkollore</li> <li>Analiza e të dhënave në lista, përfshirë të dhënat e tjera që gjenden në nivelin komunal (për shembull, listat nga Qendrat e Mjekësisë Familjare)</li> <li>Krijimi i një liste të fëmijëve të klasës së I-rë, të fëmijëve të moshës shkollore</li> <li>Dërgimi i shkresave të gjithë prindërve të fëmijëve që arrijnë në klasën I, të moshës shkollore, duke idhënë informata mbi periudhën e regjistrimit, në cilën shkollë të</li> </ul>

	<p>regjistrohen, si të regjistrohen, dokumentet e nevojshme, pse është e rëndësishme që të regjistrohen në moshën e duhur dhe informata të tjera përkatëse, përfshirë mbështetjen në dispozicion</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Letrat gjithashtu mund të shpërndahen nëpërmjet vëllezërve ose motrave më të mëdha të regjistruar tashmë në shkollë dhe nëpërmjet para-shkollarëve</li> <li>• Fushata në Radio/me postera që ofrojnë informata për kohën e regjistrimit, si të regjistrohen dhe ku të marrin mbështetjen e nevojshme</li> <li>• OJQ-të të plasojnë informata në komunitet përmes takimeve dhe mjeteve të tjera</li> <li>• Zhvillimi i programeve shkollore verore të gatishmërisë për fëmijët (dhe prindërit e tyre), të cilët nuk kanë vijuar arsimin parashkollor</li> </ul>
Akterët	DKA, regjistrimi civil, drejtoritë tjera komunale, shkollat, niveli parashkollor, OJQ-të
Çështjet që duhet të mirren parasysh	Fëmijët të cilët kyçen në arsim me vonesë kanë më shumë gjasë ta braktisin shkollimin, prandaj është shumë me rëndësi, që fëmijët të hyjnë në klasën e I-rë, në moshën e duhur.

#### **Moduli 4: Ngritja e vetëdijësisë mbi rëndësinë e arsimit dhe sistemit arsimor të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas**

Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e informimit për procesin e regjistrimit</li> <li>• Mungesa e vetëdijësisë mbi obligimin prindëror për dërgimin e fëmijëve në shkollë</li> <li>• Mungesa e ndërgjegjësisë për objektet arsimore në fëmijërinë e hershme që janë në dispozicion</li> <li>• Mungesa e vetëdijes për rolin e ndërmjetësuesve</li> <li>• Mungesa e ndërgjegjësisë për kalendarin shkollor</li> <li>• Mungesa e vetëdijes rreth shkollimit falas, ushqimit falas, transportit falas dhe teksteve shkollore falas</li> </ul>
Qëllimi	Të ngritet vetëdijësi për arsim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas dhe t'u ipen prindërve të gjitha informacionet e nevojshme për sistemin e arsimit
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e fletëpalosjeve dhe posterave në lokacione kyçe, duke përfshirë dyqanet, qendrat shëndetësore etj, me të gjithë informacionin e nevojshëm për orë plotësuese, kohën e regjistrimit dhe procesin, si dhe hollësitë kontaktuese për mbështetje</li> <li>• Takime të komunitetit për informim, organizuar bashkërisht nga ndërmjetësuesit dhe DKA apo stafit të shkollës</li> <li>• Takime informuese të organizuara në qendrat e arsimit të fëmijërisë së hershme, në qendrat e kujdesit</li> <li>• Udhëheqja e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes me përqendrim të fëmijës, gjatë ngjarjeve të komunitetit dhe festave</li> <li>• Ditë të hapura në qendrat ZhFH dhe shkolla</li> <li>• Drejtorët e shkollave dhe mësuesit vizitojnë vendbanimet dhe lagjet me ndërmjetësuesit për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe trajtuar brengat e ngritura</li> <li>• Shpërndarja e UA për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar ose nuk kanë vijuar arsimin e obliguar – MASHt (UA Nr.13/2005)</li> </ul>
Akterët	DKA, EPBMB shkollore, drejtorët e shkollave, mësuesit, ndërmjetësuesit, OJQ-të
Çështjet që duhet	Trajtoni çdo çështje që mund të kenë prindërit, veçanërisht rreth shpenzimeve të arsimit.

të mirren parasysh	Theksoni çfarë ofrohet falas dhe njoftoni prindërit se ku mund të gjejnë mbështetje (shtesë).
--------------------	---

<b>Moduli 5: Dokumentimi dhe regjistrimi</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e certifikatave të lindjes</li> <li>• Fëmijët pa dokumente</li> <li>• Mungesa e certifikatave shëndetësore (p.sh. vaksinimet)</li> <li>• Mungesa e dokumenteve tjera të kërkuara për regjistrim</li> <li>• Mungesa e dokumentacionit shkollor dhe njoftimeve për diploma për fëmijët e kthyer dhe të riadhesuar</li> </ul>
Qëllimi	Të mbështeten familjet për marrjen e tërë dokumenteve të nevojshme për fëmijët e tyre, duke mos i privuar nga e drejta e tyre në arsim gjatë procesit
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e posterave dhe fletëpalosjeve për të shpjeguar procesin e dokumentimit dhe regjistrimit në disa gjuhë, përpara periudhës së regjistrimit në shkolla</li> <li>• Shpërndarja e emrit të institucioneve dhe organizatave për të kontaktuar për regjistrim</li> <li>• Shpërndani informatat kontaktuese për institucionet dhe organizatat që ofrojnë mbështetje për dokumentacion familjeve dhe fëmijëve</li> <li>• Organizoni fushata për regjistrim, muaj regjistrimi etj.</li> <li>• Shpërndani udhëzimet administrative që parashohin obligimin e shkollave për të regjistruar fëmijët, derisa janë në pritje të dokumentacionit të huaj (UA për përcaktimin e kërkesave, kritereve dhe procedurave në përbushjen e Strategjisë për riintegrimin e personave të riadhesuar Numër: 17/ 2010 Data: 18.11.2010)</li> <li>• Të sanksionohen shkollat, që nuk i pranojnë fëmijët pa dokumente</li> </ul>
Akterët	Autoritetet përkatëse të komunës për regjistrim, DKA, EPRBM, OJQ-të, ZKKK, shkollat përfshirë edhe fëmijët.
Çështjet që duhet të mirren parasysh	Ofroni mekanizma për të siguruar, që shkollat i pranojnë fëmijët, derisa të përgatiten dokumentet e tyre.

<b>Moduli 6: Qasja e barabartë në arsim në fëmijërinë e hershme dhe në arsim parashkollor</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e vetëdijes për rëndësinë e arsimit në fëmijërinë e hershme</li> <li>• Mungesa e qasjes së barabartë në objekte për arsimin në fëmijërinë e hershme</li> <li>• Shpenzimet e dispozitës në pikën e përdoruesit</li> <li>• Çështjet e transportit për fëmijët e rinj</li> <li>• Mosdashja e prindërve për dërgimin e fëmijëve të tyre në qendrat e arsimit për fëmijërinë e hershme për arsye të ndryshme.</li> </ul>
Qëllimi	Të sigurohet që të gjithë fëmijët pavarësisht nga prapavija e tyre mund të përfitojnë nga ofrimi i arsimit në fëmijërinë e hershme
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i formave alternative të ofrimit të arsimit të fëmijërisë së hershme për të rritur mbulimin</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni që dhënia e teksteve është falas për pjesën dërmuese të familjeve më të rrezikuara</li> <li>• Shpërndani Udhëzimin Administrativ për zvogëlimin e tarifave të paguara nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore</li> <li>• Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e arsimit në fëmijërinë e hershme</li> <li>• Identifikoni, trajtoni dhe përfshini asistentë/lehtësues të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në arsimin e fëmijërisë së hershme dhe parashkollor</li> <li>• Zhvilloni strategji për asistentët romë, ashkali dhe egjiptas, që në mënyrë graduale të paguhen nga komunat</li> <li>• Përzieni komunitetet nëpër të gjithë objektin për të shmangur segregacionin</li> <li>• Hartoni programe të përfshirjes prindërore për qendrat e zhvillimit të fëmijërisë së hershme (ZHFH), duke i përfshirë etërit me një fokus të veçantë</li> <li>• Organizoni aktivitete për mësimin e gjuhëve për të përgatitur nxënësit për arsimin fillor</li> <li>• Shfrytëzoni vullnetarët për të shoqëruar fëmijët në qendrat e ZhFH-së dhe në parashkollor, kur prindërit nuk mund ta bëjnë këtë</li> <li>• Ku është i organizuar transporti me autobus, siguroni disa vende për prindërit / kujdestarët, që të jenë të rezervuara për të shoqëruar fëmijët</li> </ul>
Akterët	DKA, ofruesit e arsimit në fëmijërinë e hershme, OJQ-të, shoqatat në komunitet
Çështje që duhet të mirren parasysh	Arsimi në fëmijërinë e hershme dhe arsimi parashkollor janë çelësi për gatishmërinë në shkollë dhe për parandalimin e braktisjes së shkollës. Gjithashtu, është një fazë e rëndësishme për përfshirjen e prindërve në arsimimin e fëmijëve të tyre.

<b>Moduli 7: Mbështetja e plotë për nxënësit në rrezik të braktisjes</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Performanca e ultë</li> <li>• Sjellja përçarëse në shkollë</li> <li>• Mungesa e angazhimit të nxënësit në aktivitetet shkollore</li> <li>• Mungesa e angazhimit të prindërve në aktivitetet shkollore</li> <li>• Aktivitetet e parregullta</li> <li>• Mungesa e mbështetjes gjithëpërfshirëse në parandalimin e braktisjes së shkollës</li> </ul>
Qëllimi	Të ofrohet mbështetje e plotë nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• EPRBM-të shkollore të zhvillojnë mekanizma për identifikimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollës</li> <li>• Organizoni takime me EPRBM-të shkollore, prindërit, ndërmjetësesit, nëse e nevojshme edhe nxënësit të diskutojnë për problemet dhe të identifikojnë zgjidhjet</li> <li>• Siguroni mbështetje materiale ku e nevojshme</li> <li>• Udhëzoni fëmiun dhe familjen për shërbimet sociale dhe shëndetësore, nëse nevojitet dhe paralajmëroni ekipet komunale shumë-sektoriale për nevojat e fëmijës, ku paraqiten ato</li> <li>• Organizoni aktivitete mbështetëse për mësimnxënie (Shih Modulin 8)</li> <li>• Zhvilloni skema mentorimi</li> <li>• Përpiquni të mbani kontakte të rregullta sa më shumë që të jetë e mundur me prindërit, zyrtarisht dhe jo-zyrtarisht</li> <li>• Shfaqni menaxhmentit të shkollës dhe komunës angazhimin tuaj për mbajtjen edhe</li> </ul>



	suksesin e fëmijës
Akterët	EPRBM, sfati i shkollës, prindërit, fëmijët, mentorët, ndërmjetsuesit, Ekipet komunale për parandalimin e braktisjes së shkollës
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p><u>Mentorimi:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësoni nxënësve të zgjedhin mentorin në kuadër të shkollës apo jashtë saj</li> <li>• Zhvilloni kontratë ndërmjet mentorit, nxënësit, shkollës dhe prindërve, duke identifikuar mësimnxënien, vijimin, pjesëmarrjen dhe synimet e sjelljes si dhe përmbledhjen e përgjegjësive të secilës palë në dhënien kontributit këtyre synimeve</li> <li>• Organizoni takime zyrtare dhe jo-formale ndërmjet fëmijës dhe mentorit</li> <li>• Kur mentori është jashtë shkolle, ftojeni që të ju jep informatat kthyesë për përparimin fëmijës</li> <li>• Mbani skemën për mentorim kur fëmiju e ndërron shkollën, veçanërisht rreth kalimeve nga shkolla fillore e ultë në të mesme të lartë</li> </ul>

<b>Moduli 8: Mbështetja në mësimnxënie e nxënësve në rrezik të braktisjes</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit mbimoshë kyçen në klasë më të ulëta</li> <li>• Nxënësit nuk e zotërojnë gjuhën e mësimdhënies</li> <li>• Nxënësit mehten prapa në lëndët kryesore</li> <li>• Nuk merren parasysh ose nuk njihen nevojat e nxënësit për arsim special</li> </ul>
Qëllimi	Të mbështeten nxënësit në rrezik të braktisjes së mësimin në mënyrë koherente dhe konsekuente
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurohet që shkollat të organizojnë sistematikisht mbështetjen në mësim për studentët gjatë gjithë vitit, në grupe të vogla</li> <li>• Të themelohen sisteme me të cilat nxënësit mund të vlerësojnë progresin e tyre në shkollë</li> <li>• Të sigurohet që shkollat të kenë mekanizma që të mund t'i informojnë prindërit rregullisht në lidhje me përparimin e fëmijëve të tyre</li> <li>• Themelimi i klubit për detyra të shtëpisë</li> <li>• Sigurimi i orëve të gjuhës për të kthyerit dhe nxënësit nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, gjuha amtare e të cilëve nuk mësohet në mediumin shkollor</li> <li>• Mbështetja e zbatimit të shqipes si një kurrikulum i gjuhës së dytë</li> <li>• Organizoni orë të gjuhës së komunitetit për fëmijët për të përmirësuar gjuhën e tyre amtare</li> </ul>
Akterët	Shkollat, DKA, OJQ-të, vullnetarët nga komuniteti dhe të rinjët, MASHT-i (veçanërisht për zhvillimin e kurrikulës)
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p><u>Klubet për detyra të shtëpisë dhe për orë të gjuhës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klubet për detyra të shtëpisë/ orë të gjuhës mund të financohen nga OJQ-të dhe në mënyrë graduale të bashkë-financohen nga komuna, deri sa kjo e fundit të jetë në gjendje të mbulojë të gjitha shpenzimet</li> <li>• Klubet për detyra të shtëpisë/ orë të gjuhës mund të mbahen në shkolla/qendra të komunitetit</li> <li>• Klubet për detyra të shtëpisë/ orë të gjuhës mund t'i shfrytëzojnë vullnetarët, siç janë nxënësit më të rritur nga shkolla e mesme, vullnetarët nga rinia ose komuniteti.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Orët e gjuhës duhet të jenë të strukturuar dhe të mbështesin mësimnxënien e nxënësit në lëndën kryesore- duhet t'u mësohet fjalorthi për lëndën e caktuar krahas me aftësitë e përgjithshme gjuhësore.</li> </ul>
--	--

<b>Moduli 9: Mungesa nga shkolla</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngadalësia</li> <li>• Niveli i lartë i mos-vijimit</li> <li>• Mungesat e paarsyeshme</li> <li>• Mungesa e nxënësit brenda dhe jashtë shkolle për periudha të gjata kohore</li> <li>• Mungesa e monitorimit të vijueshmërisë</li> </ul>
Qëllimi	Të zvogëlohet shkalla e mos-vijimit
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi i sistemit të transportit shkolle për të siguruar që studentët të mund të shkojnë në shkollë me kohë</li> <li>• Identifikimi i shkollave me nivelet më të larta të mungesave dhe sjelljen e tyre së bashku për të diskutuar strategjitë dhe praktikatat më të mira</li> <li>• Mbështetja e shkollave në zbatimin e strategjisë për zvogëlimin e mungesave Vetëdijesimi i dyqaneve, kafeneve dhe vendeve argëtuese për rëndësinë dhe obligimin e fëmijëve, që të jenë në shkollë gjatë orëve të mësimin</li> <li>• Puna me dyqane, kafene dhe vende argëtuese për të zhvilluar strategji për zvogëlimin e pjesëmarrjes së fëmijëve gjatë orëve të mësimin</li> <li>• Organizimi i garave për vijueshmëri në shkolla dhe shpërblimi i nxënësve për vijueshmëri të rregullt</li> <li>• Organizimi i klubeve për mëngjes</li> <li>• Siguroni që shkollat t'u përmbahen rregullave të regjistrimit të vijueshmërisë</li> <li>• Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për rëndësinë e ndjekjes me rregull të shkollës</li> <li>• Punoni me ndërmjetësues</li> <li>• Inspektorët të verifikojnë rregullisht përputhshmërinë me vijimin e rregullt dhe rregullat e regjistrimit të vijueshmërisë</li> <li>• Komunitat duhet të analizojnë të dhënat e vijimit çdo gjysëmvetor dhe të ofrojnë mbështetje për shkollat me nivel të lartë të vijueshmërisë dhe të ndërmarrin aktivitete të tjera të përshtatshme për të trajtuar këtë çështje</li> </ul>
Akterët	DKA, shkollat, ndërmjetësuesit, prindërit, OJQ-të, organizatat rinore, organizatat në komunitet, bizneset lokale
Çështjet që duhet të mirren parasysh	Është me rëndësi që të mos fajësohen shkollat me shkallë të lartë të mos-vijueshmërisë, por të mbështeten ato, duke i përfshirë në financim të veçantë dhe burime njerëzore si dhe ndërhyrje në ngritjen e kapaciteteve. Kultura e fajësimit do të mund t'i inkurajonte shkollat për të mos raportuar në mënyrë të saktë për mos-vijueshmërinë e nxënësve.

## Moduli 10: Çështjet financiare, materiale dhe transporti

Çështjet	<ul style="list-style-type: none"><li>• Kostoja e mundësisë së dërgimit të fëmijëve në shkollë</li><li>• Mungesa dhe shpenzimet e transportit</li><li>• Mungesa dhe shpenzimet e pajisjeve shkollore</li><li>• Mungesa dhe shpenzimet e ushqimit</li><li>• Mungesa dhe shpenzimet për rroba</li></ul>
Qëllimi	Të hiqen pengesat financiare dhe materiale për qasje në arsim
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"><li>• Sigurimi i transportit falas për fëmijët që jetojnë më larg se 2 km nga shkolla</li><li>• Sigurimi adekuat dhe i lirë i transportit shkollor për fëmijët me aftësi të kufizuara</li><li>• Rishikimi i rrugëve të transportit me autobusin e shkollës për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin</li><li>• Ndarja e çantave dhe uniformave shkollore për fëmijët më të rrezikuar</li><li>• Sigurimi i furnizimeve shkollore falas për fëmijët më të rrezikuar</li><li>• Organizimi i shpërndarjes falas të rrobave dhe këpucëve para dimrit dhe para verës</li><li>• Sigurimi i shujtave falas në shkollë</li><li>• Bashkëpunimi me EPRBM-të për të siguruar që familjet më të rrezikuara të marrin përfitime sociale si dhe çdo mbështetje shtesë që ata mund të kenë nevojë, ose të kenë të drejtë për të</li><li>• Krijoni një fond me bursa për studentët e rrezikuar</li><li>• Organizimi aktivitete për mbledhjen e fondeve nga bizneset, në mënyrë që të mbështetet regjistrimi në shkollë dhe të parandalohet braktisja</li></ul>
Akterët	DKA, EPRBM, bizneset, OJQ-të, shërbimet sociale
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p><u>Fondet e bursave</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Organizoni aktivitete për mbledhje të fondve</li><li>• Zhvilloni kritere për ndarjen e bursave</li><li>• Zhvilloni kuota minimale për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta arsimore</li><li>• Zhvilloni sistem transparent për ndarjen e bursave</li><li>• Themeloni komisionin multi-sektorial për ndarjen e bursave</li><li>• Ftoni pjesëtarët e publikut të vëzhgojnë ndarjen e bursave</li><li>• Raportoni për ndarjen e bursave në mënyrë transparente çdo vit</li><li>• Publikoni fondet e bursave për akterët dhe familjet kyçe</li><li>• Ofroni bursa për arsimin e mesëm të lartë</li></ul>

## Moduli 11: Shkolla dhe komunitete gjithëpërfshirëse dhe të sigurta

Çështjet	<ul style="list-style-type: none"><li>• Stigma dhe diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve minoritare</li><li>• Mungesa e të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit kulturor ndërmjet komuniteteve</li><li>• Dhuna në dhe rreth shkollave</li><li>• Mungesa e njohurive se si të bëhen shkollat me të vërtetë gjithëpërfshirëse dhe t'i përgjigjen veçanërisht nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.</li></ul>
----------	--

Qëllimi	Të ngritet gjithëpërfshirja dhe siguria në komunitet dhe shkolla Të jepni llogaridhënie për përgjegjësitë e reja mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëdijësoni mësime të kulturës dhe traditave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas përmes seminareve dhe punëtorive të udhëhequra nga komuniteti,</li> <li>• Vetëdijësoni mësime të personelin tjetër të shkollës, prindërit dhe fëmijët mbi aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara</li> <li>• Promovoni shumëllojshmërinë në komunë përmes fushatave, duke shfrytëzuar figurat e mirënjohura të komunitetit, që janë kundër diskriminimit</li> <li>• Nxitja e shumëllojshmërisë përmes aktiviteteve kulturore dhe ngjarjeve tjera në shkolla dhe komunitet (Dita e romëve, më 8 prill, Dita ashkalinje, më 15 shkurt, Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara, më 3 dhjetor)</li> <li>• Krijoni ekipet sportive 'shumë-etnike' në shkolla dhe komunitet dhe organizoni gara sportive; promovoni pjesëmarrjen në sporte të nxënësve me aftësi të kufizuara</li> <li>• Trajnimi i mësimeve të udhëhequr nga MASHT-i për arsimin gjithëpërfshirës</li> <li>• Trajnimi i mësimeve të udhëhequr nga MASHT-i për arsimin shumë-kulturor, gjinor dhe gjithëpërfshirjen</li> <li>• Trajnimi i mësimeve të udhëhequr nga MASHT-i për disiplinë pozitive</li> <li>• Raportoni dhe trajtoni të gjitha rastet e segregacionit dhe diskriminimit në shkolla</li> <li>• Siguroni zbatimin e UA për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja dhe udhëzime të veçanta arsimore Nu: 07/2012 Data: 23/05/2012</li> <li>• Hartoni mekanizma për të siguruar që planet e arsimit individual janë hartuar, zbatuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur</li> <li>• Forconi bashkëpunimin ndërmjet shkollave, policisë në komunitet dhe organizatave prindër-mësime për parandalimin e dhunës në shkollë</li> <li>• Mbeshtetni shkollat në zhvillimin e ndërhyrjeve për parandalimin e dhunës</li> </ul>
Akterët	Akterët komunal, policia, OJQ-të, OSHC-të e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, OJQ-të e personave me aftësi të kufizuara, qendrat kulturore, qendrat sportive, organizatat e të rinjve, qendrat kulturore, shkollat, fëmijët
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p><u>Të sigurohet zbatimi i UA për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja dhe udhëzime të veçanta arsimore Nu: 07/2012 Data: 22/05/2012</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni krijimin e ekipeve multi-disiplinore për të vlerësuar fëmijët me nevoja arsimore speciale, sipas UA</li> <li>• Siguroni që protokollin e vlerësimit është i përcaktuar në mënyrë të qartë, është shpërndarë dhe njohur e kuptuar nga të gjithë akterët,</li> <li>• Siguroni që planet arsimore individuale të jenë zhvilluar sipas rregullave dhe praktikave më të mira</li> <li>• Ngritni në maksimum mundësitë e mësimeve dhe shkollave për të shkëmbyer praktikën më të mirë në arsimin gjithëpërfshirës në nivel të shkollës dhe të klasës.</li> </ul>

## Moduli 12: Shërbimet rinore dhe mbështetja në komunitet

Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e lartë e papunësisë rezulton me mungesën e motivimit për të mësuar në shkollë</li> </ul>
----------	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e mundësive për të rinjtë</li> <li>• Dhuna në rrugë</li> </ul>
Qëllimi	Të ngriten mundësitë për fëmijët dhe të rinjtë si një strategji plotësuese për parandalimin e braktisjes dhe kalimin në arsimin e mesëm të lartë
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Forconi lidhjet ndërmjet shkollave dhe botës së punës, duke ftuar profesionistë që të mbajnë fjalime në shkollë dhe duke organizuar praktika afatshkurtëra</li> <li>• Krijoni shërbime të këshillimit për karrierë në komunitetet</li> <li>• Siguroni një hapësirë për të rinjtë që të takohen dhe të organizojnë aktivitete</li> <li>• Zhvilloni skema të mentorimit ndërmjet aktivistëve të rinj dhe nxënësve të shkollave të mesme, si dhe në mes të profesionistëve dhe studentëve të shkollave të mesme</li> <li>• Organizoni aktivitete pas orëve të mësimin për fëmijët dhe të rinjtë që e mbulojnë artin, sportin, Teknologjia Informative dhe e Komunikimit (TIK) muzikën dhe aktivitete tjera të të nxënësve</li> <li>• Zhvilloni shërbime shëndetësore miqësore për të rinjtë, veçanërisht rreth mbështetjes psikologjike, shëndetit riprodhues, parandalimit me abuzim të substancave dhe rehabilitim</li> <li>• Organizoni orë shkrim-leximi për të rinjtë</li> <li>• Zhvilloni programe që kanë për synim djemtë adoleshent *</li> <li>• Siguroni që shërbimet shëndetësore dhe mbështetja psikologjike janë të qasshme për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.</li> </ul>
Akterët	Shërbimet e të rinjve në komunë, qendrat e punës, organizatat rinore, bizneset, shërbimet shëndetësore
Çështjet që duhet të mirren parasysh	* të dhënat tregojnë që djemtë kanë më shumë gjasë se vajzat të braktisin arsimin e mesëm të lartë.

<b>Moduli 13: Nga arsimi joformal në atë formal</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit mbimoshë në klasat e shkollës fillore, të ultë</li> <li>• Të kthyerit me përvoja të ndryshme arsimore</li> <li>• Praktikat e vendosjes dhe mbështetjes në diskrecion të drejtorit të shkollës</li> <li>• Mos-pajtueshmëria ndërmjet kurrikulës jo-formale dhe programeve</li> <li>• Mos-njohja zyrtare e mësimnxënies së mëparshme</li> </ul>
Qëllimi	Të harmonizohen programet jo-formale dhe kalimi ndërmjet arsimit jo-formal në atë formal në kuadër të komunës
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Harmonizoni praktikën e testeve për vendosje nëpër shkollë (për fëmijët e transferuar nga arsimi jo-formal në arsimin formal, për fëmijët më të rritur, të cilët hyjnë në shkollë me vonesë, për të kthyerit pa dokumentacion shkollor) duke zhvilluar kritere dhe udhëzime të qarta, duke njohur përvoja të mëhershme të mësimnxënies dhe pasur parasysh gjithmonë interesin e fëmijës</li> <li>• MASHT-i të trajtojë mësimdhënës në programin mësimor jo formal të arsimit</li> <li>• të zhvillohen materialet për nxënie dhe mësimdhënie, që do të zhvillohen për ofrimin e programit mësimor jo formal të arsimit</li> <li>• Organizoni orë plotësuese në muajt e verës për nxënësit, të cilët kanë munguar nga</li> </ul>

	<p>shkolla për periudha të gjata kohore, në bazë të kurrikulës jo-formale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një sistemi të portofolios për nxënësit, të cilët udhëtojnë shpesh nëpër Kosovë ose nëpër Evropë. Kjo ka për qëllim për të kapur "aftësitë e nxënësit në lëndët kryesore dhe fushat e njohurive të mbuluara në çdo shkollë që ka vijuar, me qëllim të përforcimit të vazhdimësisë së mësimnxënies së nxënësve dhe shmangies së boshllëqeve. Sistemi gjithashtu mund të përfshijë sigurimin e arsimit jo-formal.</li> </ul>
Akterët	DKA, OJQ-të, shkollat, MASHT-i (veçanërisht për zhvillimin e kurrikulës dhe zhvillimin material për arsimin jo-formal dhe për trajnimin e mësimdhënësve)
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p>Ka 2 lloje të ofrimit të arsimit jo-formal: (i) orë plotësuese gjatë verës; (ii) program zyrtar i arsimit jo-formal. Fëmijët do të ndjekin njërën ose rrugën tjetër varësisht nga nevojat e tyre. Zbatimi joformal i kurrikulumit:</p> <p>Të zbatohet plotësisht, pra me mësues të trajnuar, duke ndjekur orarin dhe rrugën e promovimit, me evaluimin e duhur të vlerësimit të mësimin.</p>

<b>Moduli 14: Mbështetja e shkollave</b>	
Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkollat janë në linjën e parë të frontit, të stërngarkuara me kërkesa dhe mungesë të burimeve dhe kapaciteteve</li> <li>Shkollave u mungon mbështetja profesionale në menaxhim</li> <li>Shkollave u mungojnë mundësitë për të diskutuar problemet dhe shkëmbimi i përvojave më të mira</li> <li>Shkollat nuk i kanë themeluar EPRBM-të dhe ekipete themeluara u mungojnë kapacitetet</li> <li>Shkollave u mungon kapaciteti dhe burimet për të bërë gjithëpërfshirje të mirëfilltë</li> </ul>
Qëllimi	Komunat me kohë duhet të sigurojnë mbështetje profesionale shkollave për çështjen e fëmijëve jashtë shkolle dhe nxënësit braktisës
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komunat monitorojnë themelimin e EPRBM-ve</li> <li>Komunat organizojnë trajnime sistematike dhe aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve për EPRBM-ve</li> <li>Komunat ofrojnë mundësi për shkollat dhe EPRBM-të për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira nëpërmjet takimeve dhe seminareve</li> <li>Komunat të zhvillojë një skemë shpërblymshme për praktikat inovative dhe më të reja dhe praktikat më të mira të zhvilluara nga shkolla dhe EPRBM-të, për të iu adresuar çështjes së fëmijëve jashtë shkolle, braktisjes të nxënësve, arsimin gjithëpërfshirës, arsimin shumë-kulturor dhe dhunës në shkolla</li> <li>Komunat të ndajnë buxhetet për ofrimin e shërbimeve mbështetëse në shkolla (psikologë, pedagogë, ndërmjetësues etj)</li> <li>Komunat të rekrutojnë, trajnojnë dhe paguajnë lehtësuesit për të zbatuar planin mësimor rom të zhvilluar nga MASHT-i</li> <li>Komunat të zhvillojnë shërbimin mbështetës, statutin e shërbimit për mbështetje si dhe të angazhohen për mbështetje të vazhdueshme të shkollës, sidomos të shkollave në zonat e privuara, zonat multi-etnike dhe zonat me popullsi të lartë migruese</li> <li>Komunat të trajnojnë mësimdhënësit për përfshirjen e prindërve</li> <li>Komunat të punësojnë të rinj dhe të zhvillojnë skema vullnetarizmi për të rritur mbështetjen e stafit për aktivitete ekstra-kurrikulare, aktivitetet pas shkollore, programet</li> </ul>

	<p>e klubeve për detyra të shtëpisë etj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunat të marrin përgjegjësi për të mbështetur shkollat në zhvillimin e mjedisve gjithëpërfshirëse.</li> </ul>
Akterët	DKA-ja, EPRBM-ja komunale, MASHT-i, ofruesit e trajnimeve për mësimdhënësit, universitetet
Çështjet që duhet të mirren parasysh	

### Moduli 15: Grumbullimi i të dhënave dhe raportimi

Çështjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e të dhënave të përditësuara për fëmijët jashtë shkolle dhe braktisës, që parandalon zhvillimin e ndërhyrjeve të synuara në nivelin komunal</li> <li>• Kultura e kufizuar e analizës dhe interpretimit të të dhënave ekzistuese në nivelin komunal</li> </ul>
Qëllimi	Të përmirësohet grumbullimi i të dhënave, analiza dhe interpretimi për të informuar zhvillimin e politikave dhe kontinuar në llogaridhënien ndaj fëmijëve
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bazuar në sistemin e identifikimit dhe monitorimit (shih Moduli 1), Komunat ofrojnë të dhëna të sakta mbi fëmijët jashtë shkolle dhe fëmijët braktisës çdo vit</li> <li>• Komunat analizojnë dhe publikojnë raportet vjetore për regjistrim, vijim, braktisje, kryerje dhe diplomim. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike, fëmijë me aftësi të kufizuara, lokalitete.</li> <li>• Komunat tregojnë se të dhënat e mësipërme janë përdorur në planifikimin e politikave, alokimin e buxhetit dhe strategjive të mbështetjes së shkollës</li> <li>• Zyrtarët e të dhënave janë të emëruar dhe trajnuar për përpunimin e të dhënave, paraqitjes së të dhënave dhe analizën e të dhënave</li> <li>• Komunat bashkëpunojnë me MASHT-in për të parë se si të përdoren më së miri të dhënat SMIA-s për qëllime lokale dhe planifikim</li> </ul>
Akterët	DKA-ja, MASHT-i, donatorët
Çështjet që duhet të mirren parasysh	<p>MASHT-i duhet të hulumtojë se si më së miri t'i komunikojë të dhënat përkatëse të SMIA-s komunave për planifikimin e tyre</p> <p>Duhet të shmangët detyra për dyfishimin e mundshëm të grumbullimit të të dhënave për aq sa të jetë e mundur</p>

### Moduli 16: Shërbimet për fëmijët e riatdhesuar dhe të kthyer

Problemet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e informacionit të përditësuar lidhur me fëmijët e riatdhesuar dhe të kthyer</li> <li>• Mungesa e komunikimit ndërmjet departamenteve në komunë</li> <li>• Mungesa e shërbimeve të duhura për fëmijët e riatdhesuar dhe të kthyer</li> <li>• Mungesa e ndërgjegjësimit për obligimin prindëror ndaj dërgimit të fëmijëve në shkollë</li> <li>• Vështirësitë e fëmijëve të kthyer për t'u integruar në sistemin arsimor të Kosovës dhe në shoqëri</li> </ul>
-----------	--

Qëllimi	Të sigurohet që fëmijët e riadhesuar dhe të kthyer të regjistrohen dhe të kenë qasje në shërbime të veçanta
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kërkohet të paktën një herë në muaj nga ZKKK-ja lista zyrtare e fëmijëve të riadhesuar dhe të kthyer për 5-14 vjeç.</li> <li>• Të kërkohet nga OJQ-të / ndërmjetësuesit / Qendrat e mësimi për të kontribuar në këtë listë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit për fëmijët e riadhesuar dhe të kthyer si dhe për fëmijët, të cilët nuk janë në shkollë.</li> <li>• Verifikimi që këta fëmijë janë në shkollë, duke kontaktuar shkollën përkatëse.</li> <li>• Informimi i psikologëve të shkollave për të monitoruar fëmijët e riadhesuar dhe të kthyer, meqë ata janë më të prirur për probleme psikologjike.</li> <li>• Kërkesë nga shkolla për të vlerësuar aftësitë e gjuhës së fëmijëve të kthyer dhe fëmijëve të riadhesuar, që të përpilojë një listë të nxënësve, të cilët kanë nevojë për orë plotësuese të gjuhës.</li> <li>• Organizimi i orëve plotësuese të gjuhës për fëmijët e riadhesuar dhe të kthyer, nëse paraqitet nevoja. Të paktën një herë në vit, të kërkohen fonde nga Departamenti për Riadhesim në MPB (ose nga MASHT-i) për këtë çështje.</li> <li>• Ngritja e vetëdijes së prindërve për rëndësinë e dërgimit të fëmijëve në shkollë dhe në orët plotësuese. EPRBM-të, ndërmjetësuesit dhe OJQ-të duhet të kenë qasje më shumë tek prindërit.</li> </ul>
Akterët	DKA-ja, ZKKK-ja, EPRBM-të, OJQ-të, Qendrat e Mësimi, Ndërmjetësuesit.
Konsideratat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas rregulloreve administrative, fëmijët e riadhesuar duhet të regjistrohen në shkollë në nivelin e duhur, pa asnjë dokument. Nostrifikimi i dokumenteve mund të bëhet në faza më të mëvonshme.</li> <li>• Fëmijët e kthyer dhe të riadhesuar kanë tendencë të jenë më shumë në rrezik të braktisjes së shkollës. EPRBM-të shkollë duhet të informohen rreth tyre për të trajtuar këtë çështje në një fazë më të hershme.</li> <li>• Familjet e riadhesuara janë në një situatë shumë të vështirë dhe kjo mund të çojë në mos-kushtimin e vëmendjes së mjaftueshme për edukimin e fëmijëve.</li> <li>• Stafi i ZKKK-së ka mandat për të bërë vizita të rregullta monitoruese të familjeve të riadhesuara. Është e rëndësishme që atyre t'u rikujtohet për t'i këshilluar prindërit në lidhje me arsimimin e fëmijëve. Orët plotësuese të gjuhës zakonisht organizohen si më poshtë:</li> <li>• Orët për dy nivele (fillestar të plotë dhe fëmijë me pak njohuri të gjuhës). Fond prej 60 orëve për 3 ose 4 orë, çdo të shtunë</li> <li>• Një mësues për klasë (maksimum 20 nxënës)</li> <li>• Vlerësimi në fillim dhe në fund të orëve</li> <li>• Sigurimi i shkollës, mësimdhënësit, transportit dhe ushqimit për fëmijët që ndjekin mësimin plotësues janë në dispozicion në DKA</li> <li>• Materiali pedagogjik për klasa, trajnerë dhe për mësues janë në dispozicion në MASHT.</li> </ul>



### 3. FORMULARI I PLANIT TË VEPRIMIT

<b>CAKU 1</b>						
Aktivitetet	Përgjegjësia	Partnerët tjerë implementues	Korniza kohore	Shpenzimet	Burimi financiar	Treguesit
1.1						
1.2						
1.3						
1.4						

<b>CAKU 2</b>						
Aktivitetet	Përgjegjësia	Partnerët tjerë implementues	Korniza kohore	Shpenzimet	Burimi financiar	Treguesit
2.1						
2.2						
2.3						
2.4						